



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____/2024
Datë: 30.01.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.110/04-29365 i datës 28.12.2022, si dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr.05/L-009, në mbledhjen e mbajtur me datë.30.01.2024, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5 të rendit të ditës: Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit “ SH.A, e miratoi këtë:

V e n d i m
Për

mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit “ SH.A


1. Aprovohet Propozim Vendimi për Mbështetje Financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit“ SH.A, me qëllim të furnizimit me lëndën e parë të Biomassës për përmbylljen e sezonës 2023-2024.
2. Mjetet për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit“ SH.A të ndahen nga Kategoria e Subvencioneve të Zyrës së Kryetarit të Komunës nga Kodi Buxhetore 10/632/16016/200/00000/0111, dhe kodi 21/632/16016/200/00000/0111 në vlerë prej 300,000€ .
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	22.01.2024 01-413/01-875
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës 
Lënda:	Propozim vendim për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A


Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, me datën 22.01.2024 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për mbështetje financiare për Ndërmarrjen Publike "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A, me qëllim të furnizimit me lëndën e parë të Biomasës për përmbylljen e sezonit 2023/2024.
2. Mjetet për mbështetje financiare për Ndërmarrjen, të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit nga kodi buxhetor 632/160/13, në vlerë prej 300,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.

Me respekt!



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" pr Rezinë, Gjakovë
Tel: +383 (0) 46 127 086
E: info@ngrohtorja.org

NUI: 811326471

web:www.ngrohtorja.org

Me: 23.01.2024

Nr. 72

Për: Komuna e Gjakovës
Kryetarin e Komunës
z. Ardian Gjini

Nga: NP Ngrohtorja e Qytetit SHA Gjakove
Kryeshef Ekzekutiv
z. Blerim Halilaj

K E R R E S E

I nderuar Z. Gjini

Me date 04.05.2023 me nr. protokoll 288 kemi nënshkruar marrëveshjen për subvencionim në vlerën prej 300.000 Euro me Ministrinë e Ekonomisë për sezonin ngrohës 2023-2024, ku me datë 12.09.2023 kemi bere hapjen e tenderit Furnizim me Gdhendla druri Biomase , ku fitues ka qene NPT Gresa Commerc në vlerën prej 506,420.60 Euro për 3500 Ton.

Po ashtu me datë 27.11.2023 me nr. protokoll 770 nga Komuna e Gjakovë kemi pranuar konfirmimin për disponueshmeri të mjeteve për vitin fiskal 2024 në vlerën prej 300.000 euro për blerjen e lëndës së parë Biomase, e cila është e domosdoshme për ta përmbyllur me sukses sezonin ngrohës 2023/2024, pasi që subvencioni nga Ministria e Ekonomisë është i pamjaftueshëm për të përmbyllur komplet sezonin ngrohës.

Me datë 04.12.2023 kemi bere hapjen e tenderit Furnizim me Gdhendla druri- Biomase Faza e dytë, ku fitues ka qenë Grupi i Operatoreve Ekonomik NPT Burimi; Etniku Group SHPK në vlerën prej 428,487.50 Euro për 3500 Ton, me datë 10.01.2024 me nr. protokoll 42 kemi nënshkruar dhe kontratën ku nga kjo datë ka filluar dhe furnizimi me Biomase.

Për operimin me ngrohje për te gjithë sezonin ngrohës kemi kontraktuar tek te dy kontratat në total 7000 Ton Biomase, e cila ka kushtuar në total prej 934,908.10 Euro, ku 300.000 Euro janë te zotuar nga Ministria e Ekonomisë dhe 300.000 Euro nga Komuna e Gjakovës ne total prej 600.000 Euro për sezonin ngrohës 2023-2024 , ndërsa pjesa tjetër do te paguhet nga të hyrat e inkasimeve.

Me respekt
Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë

